


KRITERE TË NDRYSHME PËR PROKURIME TË NJËJTA



KRITERE TË NDRYSHME PËR PROKURIME TË NJËJTA

COPYRIGHT © 2020.

Kosova Democratic Institute (KDI). Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autor: Fjolla Uka

Editor: Edita Mustafa Salih

Dizajn dhe faqesje: Envinion

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Kosovë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

KONTEKSTI.....	6
PROBLEMI	7
PËRMBLEDHJA E HULUMTIMIT	9
Kërkesat e pranueshmërisë – Rasti	9
Kërkesat minimale të kualifikimit - Raste.....	9
AUTORITETI KONTRAKTUES I NJËJTË - KRITERE TË NDRYSHME NË DOSJE TË TENDERIT.....	10
Autoritete Kontraktuese të ndryshme - Kritere të ndryshme në Dosje të Tenderit	10
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	13

KONTEKSTI

Vendosja e kritereve jo standarde në Dosje të Tenderit për aktivitete të ngjashme prokurimi konsiderohet që mund të kufizojë konkurrencën dhe të krijojë rrethana diskriminuese, duke përshtatur kriteret e DT për një kompani të caktuar dhe në këtë mënyrë duke favorizuar atë gjatë garës për fitim të tenderit. Manipulimet e tilla shpijnë në shpërblime me kontratë të kompanive “me lidhje të forta”, të cilat më pas ofertojnë me çmime më të larta se çmimet e tregut e në disa raste edhe me çmime më të ulëta se çmimi i tregut duke përfituar nga cilësia e dobët e materialeve/punës/shërbimit apo mos ofrimit fare të shumicës së punëve/shërbimeve/furnizimeve për të cilat janë kontraktuar. Si rrjedhojë e kësaj dukurie, për kontrata publike nga buxheti i shtetit paguajmë më shtrenjtë se çmimi i tregut ose do të marrim cilësi të dobët të asaj që kemi kontraktuar.

Në rrethana të tilla, Operatori Ekonomik i njëjtë, për një furnizim, punë apo shërbim të njëjtë, mund të fitoj tenderin nga një Autoritet Kontraktues, ndërsa mund të mos i plotësojë kriteret e Dosjes së Tenderit tek një Autoritet Kontraktues tjetër.

Për të kuptuar problemin, në mars 2020 KDI ka mbajtur një fokus grup¹ me zyrtarët e prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese të nivelit lokal dhe qendror për të diskutuar lidhur me praktikën e vendosjes së kritereve të Dosjes së Tenderit në institucionet e tyre. Zyrtarët e prokurimit pranojnë që kriteret e Dosjes së Tenderit në institucionet në të cilat ata punojnë për punë/shërbime apo furnizim e të njëjta, janë të ndryshme nga institucionet tjera. Jo konsistenca në vendosjen e kritereve të DT, për aktivitete të prokurimit të njëjta, ndodhë për shkak të mungesës së vullnetit për të krijuar një praktikë uniforme brenda AK-së si nga ana e zyrtarëve të prokurimit e sidomos hartuesve të specifikimeve teknike - njësisë së kërkesës, por në anën tjetër mos rregullimi me ligj i kësaj çështjeje ua ka lënë këtë mundësi atyre. Problemi është se në këtë mënyrë mund të manipulohet me kriteret

e DT dhe rrjedhimisht me dhënien e tenderit kompanive të paracaktuara. Nga diskutimi në këtë fokus grup është identifikuar nevoja për standardizim të kritereve të Dosjes së Tenderit përmes **formularëve standard të kritereve të Dosjes së Tenderit**, që përveç se do të lehtësonte punën e zyrtarëve të prokurimit do të ndikonte edhe në lehtësimin e përgatitjes së ofertave nga Operatorët Ekonomik.

¹ Fokus grupi për “Kriteret e DT” me zyrtarët e prokurimit të AK-ve të ndryshme dhe KRPP, organizuar nga KDI më datë 03 mars 2020. <http://kdi-kosova.org/aktivitetet/mbahet-punetoria-lidhur-me-standardizimin-e-kritereve-ne-dosjet-e-tendereve/>

Në Kosovë rreth



e buxhetit shtetëror
shpenzohet përmes
prokurimit publik.

Gjatë vitit 2018, janë realizuar gjithsej



12,412

aktivitete të prokurimit, ndërsa
vlera e kontratave të nënshkuara
gjatë vitit 2018 ishte

631,622,686.02 eur.

PROBLEMI

Në Kosovë rreth 30% e buxhetit shtetëror shpenzohet përmes prokurimit publik. Gjatë vitit 2018, janë realizuar gjithsej 12,412² aktivitete të prokurimit, ndërsa vlera e kontratave të nënshkuara gjatë vitit 2018 ishte 631,622,686.02 euro.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) gjatë vitit 2018 ka pranuar 763 ankesa, ndërsa më shumë se gjysma e vendimeve të OSHP-së ishin në favor të Operatorëve Ekonomik ankues (OE).³ Ndër llojet e ankesave që deponohen në OSHP janë edhe ankesat lidhur me kriteret/kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT). Ankesat për kriteret diskriminuese të Dosjes së Tenderit shpesh bëhen jashtë afatit të paraparë me ligj⁴ pasi Opeeratorët Ekonomik ato i listojnë në radhën e ankesave tjera që bëhen lidhur me vendimin e Autoritetit Kontraktues, të tillat edhe OSHP mund të mos i trajtojë pasi janë të jashtë afatshme.

Për më tutje, raporte të shumta nga mediat⁵ dhe shoqëria civile⁶, kanë ngritur vazhdimisht shqetësime lidhur me kriteret për dhënien e tenderëve dhe manipulimet me specifikat teknike për qëllime favorizuese.

KDI përmes monitorimit aktiv të prokurimit publik në Autoritete Kontraktuese (AK) të ndryshme ka vërejtur që kriteret e Dosjes së Tenderit për produkte, furnizime e punë të ngjashme ndryshojnë nga institucioni në institucion, e me raste edhe brenda vetë institucionit. Gjithashtu është vërejtur që për punë, furnizime apo shërbime të ngjashme Autoritetet Kontraktuese të ndryshme paguajnë edhe çmime të ndryshme.

Në këtë publikim KDI paraqet disa raste konkrete ku shpërfaqet dukuria e aplikimit të kriterëve jo standarde, për aktivitete të prokurimit të njejta, në Dosje të Tenderit në Autoritete Kontraktuese të ndryshme, por edhe brenda një Autoriteti

2 Raporti vjetor i punës së KRPP-së për vitin 2018, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Notices/alb/385/Raporti%20vjetor%202018%20KRPP%20Shqip.pdf>

3 Raporti vjetor i punës së OSHP-së për vitin 2018, i qasshëm në: <file:///C:/Users/fjolla.uka/Downloads/Raporti-Vjetor-2018.pdf>

4 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Neni 108/A

5 media

6 KDI; D+; KDI: Mbi 70% e shkeljeve në prokurim bëhen në vlerësim të ofertave, 2017 KOHA Ditore



Kontraktues. Vendorsja e kritereve të ndryshme në Dosje të Tenderit, për aktivitete të njëjta të prokurimit përbrenda një Autoriteti Kontraktues por edhe në Autoritete Kontraktuese të ndryshme, janë indikatorë se këto kritere edhe mund të jenë të manipuluar.⁷

Një mekanizëm që do të mund të shmangte rreziqet nga manipulime të tilla me kritere është krijimi i **formularit standard të kritereve të Dosjes së Tenderit apo Njoftimit për Kontratë**.

Formulari standard do të krijohej për aktivitete prokuruese sipas llojit të kontratës (punë, furnizime, shërbime) dhe vlerës së kontratës (vlerë e vogël, e mesme apo e madhe). Autoritetet Kontraktuese varësisht prej vlerës dhe llojit të kontratës më pas do të orientoheshin për përcaktimin e kritereve të Dosjes së Tenderit. Në një situatë të tillë, edhe Operatorët Ekonomik do ta kishin më të lehtë përgatitjen e

ofertave ngase do t'i kishin të njohura kërkesat e Dosjes së Tenderit paraprakisht varësisht prej llojit të aktivitetit dhe vlerës.

Natyrisht që një nismë e tillë do të duhej të mbështetej edhe me ligj, andaj Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) rekomandohet t'a adresojë këtë çështje, tani kur edhe është në fazën e hartimit të kornizës së re ligjore (koncept dokumentit) për prokurimin publik, e më pas edhe përmes akteve nënligjore.

Një praktikë e mirë dhe e ndërmjetme që do të mund të zbatohet nga Autoritetet Kontraktuese deri në një zgjidhje gjithëpërfshirëse me ligj, është që secili Autoritet Kontraktues të krijojë praktikë të brendshme në vendosjen e kritereve të njëjta të Dosjes së Tenderit për aktivitete të prokurimit të njëjta.



KDI përmes monitorimit aktiv të prokurimit publik në Autoritete Kontraktuese (AK) të ndryshme ka vërejtur që kriteret e Dosjes së Tenderit për produkte, furnizime e punë të ngjashme ndryshojnë nga institucioni në institucion, e me raste edhe brenda vetë institucionit."

⁷ Konkluzion nga fokus grupi i organizuar nga KDI më 03 mars 2020, me zyrtarë të prokurimit të AK-ve të ndryshme dhe KRPP



PËRMBLEDHJA E HULUMTIMIT

Kritere e Përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për t'u konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike.⁸ Në kuadër të kritereve të përzgjedhjes hyjnë **kërkesat e pranueshmërisë**, dhe **kërkesat minimale të kualifikimi**.

Kërkesat e pranueshmërisë – Rasti

Neni 65 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), cakton kushte për pranueshmërinë e kandidatëve apo tenderuesve. Nëse ndonjë nga këto kushte nuk plotësohet nga Operatori Ekonomik, ai shpallet i papërgjegjshëm. Autoritetet Kontraktuese në kuadër të kritereve të pranueshmërisë zakonisht i listojnë vetëm dy, e që janë: *Vërtetim nga ATK që Operatori Ekonomik nuk është në vonesë për pagesën e tatimeve; Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike që Operatori Ekonomik nuk është shpallur i falimentuar në dy vitet e fundit.*

Në kuadër të kritereve të pranueshmërisë që listohet në nenin 65 të LPP bënë pjesë edhe *kërkesa për dëshmi nga gjykata që OE, ndonjë drejtues, drejtor a menaxher i kompanisë, në 10 vitet e fundit nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile.* Kjo kërkesë nuk është e aplikueshme në Dosjet e Tenderit nga të shumicës së AK-ve. KDI ka hasur këtë kërkesë vetëm në DT e Ministrisë së Infrastrukturës dhe në Policinë e Kosovës, ndërsa tek shumë Autoritetet Kontraktuese si: Agjencia Qendrore e Prokurimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universtitari i Kosovës, Trepça sh.a, Zyra Kombëtare e Auditimit, nuk është hasur në ndonjë Dosje të Tenderit që ka përfshirë këtë kërkesë.

Kërkesat minimale të kualifikimit - Raste

Ligji për Prokurimin Publik me nenet 66, 68 – 71, ka parashikuar kërkesat që tenderuesit duhet të plotësojnë rreth **përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare** dhe **aftësitë teknike dhe profesionale të tenderuesit.**

Kur është fjala për vërtetimin e gjendjes ekonomike e financiare si dhe aftësive teknike dhe profesionale në LPP janë të listuara referencat nga të cilat Autoritetet Kontraktuese duhet të kërkojnë ndonjërin (një apo më shumë nuk është e përcaktuar), ndërsa sa i përket kritereve për aftësitë teknike dhe profesionale, në ligj janë listuar kërkesat që mund të i vendosen në Dosje të Tenderit varësisht prej llojit të aktivitetit. Pra mbetet në diskrecionin e Autoriteteve Kontraktuese se çfarë kërkesa do të përfshijnë në Dosje të Tenderit.

⁸ RRUOP i qasshëm në: <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/04/rruopp13042018.pdf>



AUTORITETI KONTRAKTUES I NJËJTË - KRITERE TË NDRYSHME NË DOSJE TË TENDERIT

Në dymbëdhjetë (12) tenderë për furnizim me barna dhe material medicinal në ShSKUK⁹ të analizuar nga KDI¹⁰, ndonëse bëhet fjalë për aktivitete të prokurimit të llojit furnizim, kriteret e Dosjes së Tenderit kanë qenë të ndryshme kur është bërë fjalë për kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale. Përderisa tek tenderët për furnizim me material medicinal janë kërkuar **referenca të kontratave të mëparshme për furnizime të ngjashme**, në tenderët për furnizim me barna nuk është përfshirë një kërkesë e tillë.

Autoritete Kontraktuese të ndryshme - Kritere të ndryshme në Dosje të Tenderit

Agjencia Qendore e Prokurimit (AQP) me rreth 165 Autoritete Kontraktuese në nivel lokal e qendror përbëjnë institucionet të cilat kryejnë prokurime¹¹ në Kosovë. Në praktikë janë të shumta rastet kur Autoritetet Kontraktuese të ndryshme vendosin kritere të ndryshme të Dosjes së Tenderit, për aktivitete të prokurimit të njëjta. Në vazhdim paraqiten disa raste që pasqyrojnë më së miri problematikën e lartëcekur.

Rasti 1

Ministria e Infrastrukturës për tenderin për **“Furnizimi dhe montimi i ndriçimit në rrugët rajonale”**¹² nuk ka paraparë kërkesë, as për kapacitetet ekonomike e financiare as për ato teknike e profesionale, kurse në anën tjetër Komuna e Deçanit për tenderin **“Rregullimi i ndriçimit publik eficient në Deçan”**¹³, ka kërkuar: Dëshmitë për kontrata të njëjta në tri vitet e fundit; është caktuar minimum i numrit të punëtorëve që duhet ti ketë kompania fituese; kërkesa për caktimin e menaxherit të kontratës nga ana e kompanive me shkollim dhe përvojë të caktuar; dhe kërkesa tjera teknike për produktet.

Tenderi i Komunës së Deçanit edhe pse është dukshëm me vlerë më të ulët se ai i Ministrisë së Infrastrukturës, kërkesat e Dosjes së Tenderit janë dukshëm më të larta.

9 Dosjet e Tenderit për furnizim me Barna, Material medicinal dhe Citostatik me nr. të prokurimit: 00220-19-905-111, 00220-19-908-111, 00220-19-1250-111, 00220-19-2031-111, 00220-19-2198-111, 00220-19-2516-111, 00220-19-2675-111, 00220-2831-111, 00220-3566-111, 00220-19-2142-111, 00220-19-2446-111, 00220-19-3566-111.

10 Raporti i KDI-së “Kriteret e tenderëve, ndikimi në konkurrencë” i qasshëm në: <http://kdi-kosova.org/publikimet/kriteret-e-tenderëve-ndikimi-ne-konkurrence/>

11 Raporti vjetor i KRPP-së për vitin 2018. I qashëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Notices/alb/385/Raporti%20vjetor%202018%20KRPP%20Shqip.pdf>

12 Numri i prokurimit: 2019/205-19-8398-1-1-1

13 Numri i prokurimit: 2019/631-19-8013-5-2-1



Agjencia Qendore e Prokurimit (AQP) me rreth

165

Autoritete Kontraktuese në nivel lokal e qendror përbëjnë institucionet të cilat kryejnë prokurime në Kosovë.

Rasti 1

Ministria e Infrastrukturës për tenderin për "Furnizimi dhe montimi i ndriçimit në rrugët rajonale" nuk ka paraparë kërkesë, as për kapacitetet ekonomike e financiare as për ato teknike e profesionale,

Rasti 2

Ministria e Infrastrukturës, Zyra Kombëtare e Auditimit, Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për shërbimet e përkthimit, në Dosjet e Tenderit për këto shërbime, kanë përfshirë kërkesa të ndryshme.

Rasti 3

Për tenderët për furnizimi me zhavorr, kriteret e Dosjes së Tenderit kanë ndryshuar shumë, në pesë Autoritete Kontraktuese të ndryshme si: Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Prizrenit, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Suharekës dhe K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" sh.a.

Rasti 2

Ministria e Infrastrukturës, Zyra Kombëtare e Auditimit, Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe Ministria e Punëve të Brendshme, **për shërbimet e përkthimit**¹⁴, në Dosjet e Tenderit për këto shërbime, kanë përfshirë kërkesa të ndryshme.

Përderisa Ministria e Infrastrukturës dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit në Dosje të Tenderit kanë përfshirë vetëm **kërkesën për numrin minimal të stafit me përgatitje të caktuar**, Zyra Kombëtare e Auditimit ka kërkuar vetëm **referenca për së paku tri kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit**, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme ka kërkuar edhe **referencat për kontrata paraprake për punë të ngjashme** edhe ka caktuar **numrin minimal të stafit me përgatitje të caktuar**.

Në rastin e AQP-së, bëhet fjalë për kontratë me vlerë të madhe ndërsa tri rastet tjera janë kontrata me vlerë të mesme. Nga kjo mund të kuptojmë që kriteret e Dosjes së Tenderit nuk varen prej vlerës së parashikuar por prej Autoritetit Kontraktues që e shpallë atë tender.

Rasti 3

Për **tenderët për furnizimi me zhavorr**, kriteret e Dosjes së Tenderit kanë ndryshuar shumë, në pesë Autoritete Kontraktuese të ndryshme si: Komuna e Hanit të Elezit¹⁵, Komuna e Prizrenit¹⁶, Komuna e Fushë Kosovës¹⁷, Komuna e Suharekës¹⁸ dhe K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" sh.a.¹⁹. Vlerat e këtyre pesë tenderëve janë të ndryshme duke filluar nga vlera e vogël deri te ajo e madhe, por edhe kohëzgjatja e kontratave është e ndryshme.

Kërkesa sa i përket gjendjes ekonomike dhe financiare kanë përfshirë vetëm dy nga këto pesë Autoritete Kontraktuese, Komuna e Prizrenit dhe Komuna e Suharekës. Të dy këto Autoritete Kontraktuese kanë kërkuar **dëshmi për qarkullim financiar** në një shumë të caktuar në tre vitet e fundit.

Ndërsa, që të gjitha këto Autoritete Kontraktuese kanë përfshirë në Dosjet e tyre të Tenderit kërkesat sa i përket mundësive teknike dhe profesionale. Me që bëhet fjalë për furnizime, të gjitha këto Autoritete Kontraktuese kanë kërkuar **dëshmi për përfundimin e kontratave të ngjashme në tre vitet e fundit**. Kjo madje ishte kërkesa e vetme e përfshirë në Dosjen e Tenderit të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" sh.a..

14 Tenderët me numër prokurimi: 205-20-528-2-2-1; 214-19-4171-2-2-1; UA/2016-20-591-2-1-1; 302-20-133-2-2-1.

15 Tenderi me numër prokurimi: 659-18-4339-1-3-6

16 Tenderi me numër prokurimi: 622-19-1256-1-1-1

17 Tenderi me numër prokurimi: 612-19-7601-1-2-1

18 Tenderi me numër prokurimi: 624-19-8915-1-2-1

19 Tenderi me numër prokurimi: 70433702-19-5234-1-2-1



Një minimum të paisjeve të detyrueshme e kanë kërkuar të gjitha Autoritetet Kontraktuese (përveç K.R.U. "Hidroregjioni jugor" sh.a.), mirëpo numri i pajisjeve që është kërkuar që të ketë në posedim Operatori Ekonomik ndryshon shumë. Përderisa Komuna e Suharekës ka përcaktuar një minimum prej dy pajisjesh, katër paisje ka kërkuar Komuna e Fushë Kosovës kurse Hani i Elezit ka kërkuar nga Operatori Ekonomik që të posedojnë minimum 5 pajisje ani pse vlera e këtij tenderi ishte dukshëm më e ulët se tenderët e dy komunave tjera. Në anën tjetër Komuna e Prizrenit ka kërkuar 14 pajisje nga Operatori Ekonomik.

Kërkesën për **numrin minimal të punëtorëve** që duhet ta ketë Operatori Ekonomik e kanë përfshirë në Dosje të Tenderit Komuna e Prizrenit dhe Komuna e Fushë Kosovës.

Përderisa Prizreni ka kërkuar që Operatori Ekonomik të ketë minimum 20 punëtorë, Fushë Kosova ka kërkuar minimum katër punëtorë. Për më shumë Prizreni ka shkuar një hap më tutje duke kërkuar nga Operatori Ekonomik që gurthyesi nga i cili merret materiali të mos jetë më larg se 15 km nga qyteti i Prizrenit.

Siç mund të shihet Komuna e Prizrenit prin me numrin e kritereve të Dosjes së Tenderit por njëkohësisht tenderi i Komunës së Prizrenit ishte i vlerës dukshëm më të lartë nga tenderët e Autoriteteve Kontraktuese të tjera.



Në dymbëdhjetë (12) tenderë për furnizim me barna dhe material medicinal në ShSKUK të analizuar nga KDI, ndonëse bëhet fjalë për aktivitete të prokurimit të llojit furnizim, kriteret e Dosjes së Tenderit kanë qenë të ndryshme kur është bërë fjalë për kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale.



REKOMANDIME

Autoritete Kontraktuese të ndryshme por edhe Autoriteti Kontraktues i njëjtë vendosin kërkesa të Dosjes së Tenderit të ndryshme për prokurime të njëjta. Në një situatë të tillë mund të ndodhë që i njëjti Operator Ekonomik të shpallet fitues për një aktivitet të prokurimit të shpallur nga një Autoritet Kontraktues i caktuar, ndërsa të mos i përmbush kriteret e Dosjes së Tenderit në aktivitetin e njëjtë të prokurimit të një Autoriteti Kontraktues tjetër. Me qëllim të shmangies së situatave të tilla KRPP duhet të marrë hapa konkretë në standardizimin e kriterëve të Dosjes së Tenderit duke krijuar formularë standard për kriteret e DT (sipas vlerës dhe llojit të aktivitetit).

- KRPP në kuadër të ndryshimeve aktuale në Ligjin për Prokurimin Publik duhet të adresojë edhe këtë çështje dhe më pas të nxjerr akte nënligjore me udhëzime konkrete për AK-të.

Ndonëse ligji u jep të drejtë Autoriteteve Kontraktuese që të vendosin se çfarë kërkesash rreth mundësive teknike e profesionale do të përfshijnë në Dosje të Tenderit, e duke parë që raste kur kriteret e DT ndysojnë edhe brenda një Autoriteti Kontraktues do të ishte praktikë e mirë që përderisa nuk vendoset një standard i kriterëve të DT me akte normative:

- Autoritetet Kontraktuese mund praktikojnë vetë një konsistencë në vendosjen e kriterëve të njëjta të Dosjeve të Tenderëve për aktivitete të njëjta të prokurimit, gjithmonë duke përzgjedhur kriteret të cilat nuk rezultojnë me ankesa të shumta nga Operatorët Ekonomik. Në këtë mënyrë do të jetë më lehtë edhe për zyrtarët e prokurimit të përgatisin njoftimin për kontratë, por edhe Operatorët Ekonomik do të ishin më të përgatitur paraprakisht për kriteret që u drejtohen atyre varësisht prej aktiviteteve të prokurimit.



LIMITIMET

Kjo analizë është e kufizuar në monitorimin e prokurimit publik në katër institucione të nivelit qendror dhe gjashtë të nivelit lokal, respektivisht një mostër prej vetëm rreth 5.3% të Autoriteteve Kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu edhe fokus grupi i organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës me datën 22 Janar 2020 ishte në përbërje të vetëm 12 përfaqësuesve nga institucione kyçe në posedimin e informatave të cilat mund të ndihmojnë në përmirësimin e proceseve të menaxhimit të kostos dhe hulumtimit të tregut me qëllim të sigurimit të vlerës për parane në shpenzimet publike.

REFERENCAT

- 1 Project Management Institute, **Project Management Body of Knowledge**, Fifth Edition, 2013
- 2 Qeveria federale e SH.B.A, **Rregullat Federale të Blerjeve/Prokurimit, Pjesa 10 – Hulumtimi i tregut**, qasur me 20 maj 2020
- 3 Bashkimi Evropian, Direktiva 2014/24/EU, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës, 26 shkurt 2014
- 4 Chartered Institute for Procurement and Supply, **Global Standard for Procurement and Supply 2018**
- 5 Ligji për prokurim publik i Turqisë, praktikat e hartimit të kriterëve të dosjes së tenderëve sipas kategorisë së prokurimit



